



**REPUBLIKA E KOSOVËS /  
REPUBLIKA KOSOVA / KOSOVA CUMHURIYETI**

---

**C.nr.1168/13**

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN**, gjyqtari Valon Totaj, me sekretaren juridike Drita Qerreti, në kontestin e paditësit KEK – Distrikti në Prizren, kundër të paditurit M. O. D. nga fshati P. komuna e Prizrenit, për shkak të kompensimit të dëmit, vlera e kontestit 149,64 euro, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor, me datën 26.12.2014, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

**I. APROVOHET** në tërësi kërkesëpadia e paditësit KEK – Distrikti në Prizren, **si e bazuar.**

**II. DETYROHET** i padituri M. D. nga fshati P. komuna e Prizrenit, që në emër të kompensimit të dëmit material, t’ia paguaj paditësit KEK – Distrikti në Prizren shumë prej 149,64 euro, me kamatë sikur për mjetet e deponuara në bankat komerciale të Kosovës mbi një vjet pa dedikim të caktuar, duke e llogaritur atë nga dita e parashtrimit të padisë, e deri në pagesën definitive të tyre, si dhe në emër të shpenzimeve të procedurës t’ia paguaj paditësit shumë në lartësi prej 15 €, të gjitha këto në afatin prej 15 ditëve pas ditës së pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.

**A r s y e t i m**

*Pretendimet e palëve ndërgjyqëse*

Paditësi KEK - distrikti në Prizren, pranë kësaj gjykate ka parashtruar padi kundër të paditurit M. D. nga fshati P. komuna e Prizrenit, përmes së cilës ka theksuar se paditësi me aktgjykimin e plotfuqishëm të Gjykatës Komunale në Prizren P.nr.888/11, të datës 14.09.2012, është shpallur fajtor për veprën penale të vjedhjes dhe është dënuar me dënimin me gjobë në lartësi prej 200 euro, më gjerësisht sikurse në këtë aktgjykim. Me të njëjtin aktgjykim, për realizimin e kërkesës pasuroro juridike, paditësi është udhëzuar në kontest të rregullt civil. Sipas padisë, i padituri me datë 04.02.2011, përveqse kishte shkaktuar veprën penale të cekur si më lartë, ai i ka shkaktuar edhe dëm paditësit ngase në mënyrë të kundërligjshme dhe të pa autorizuar ka shpenzuar energjinë elektrike në vlerë prej 149,64 euro, andaj edhe nga gjykata është kërkuar që të aprovohet kërkesëpadia, ashtu që të detyrohet i padituri që t’ia kompensojë dëmin paditëses në shumë e lartcekur.

Edhe gjatë shqyrtimit gjyqësor i autorizuari i paditësit B. P. ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë theksimeve të cekura në padi dhe kërkesëpadi. Në fjalën e tij të fundit gjykatës i ka propozuar që ta aprovojë kërkesëpadinë si të bazuar, ashtu që të detyrohet i padituri, që paditësit t'ia kompensojë dëmin në shumë prej 149,64 euro. Shpenzimet procedurale i ka kërkuar dhe atë vetëm për taksë gjyqësore në shumë prej 15 euro.

I padituri M. D., përgjatë shqyrtimit gjyqësor si dhe në fjalën përfundimtare të tij, ka deklaruar se e kundërshton në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë dhe i propozon gjykatës që ta refuzoj si të pa bazë padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit KEK – Distrikti në Prizren.

### *Gjendja faktike e vërtetuar*

Për vërtetimin e drejtë të gjendjes faktike, gjykata ka administruar këto prova: aktgjykimin e plotfuqishëm të Gjykatës Komunale në Prizren me numër P.nr.888/11 të datës 14.09.2012; si dhe kopjen e faturës me numër DPZ11HP06248 të datës 13.05.2011.

Gjykata pas vlerësimit të pohimeve të palëve ndërgjyqëse dhe provave të lartë cekura, në kuptimin e nenit 8 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha së bashku ka gjetur se:

**Kërkesëpadia e paditësit është e bazuar.**

Në bazë të aktgjykimit të plotfuqishëm të Gjykatës Komunale në Prizren P.nr.888/11, të datës 14.09.2012, gjykata e ka provuar faktin se i padituri është shpallur fajtor dhe është vërtetuar përgjegjësia penale e tij për veprën penale të vjedhjes nga neni 252 paragrafi 1 të KPK-së, ku me veprimet e tij ai i ka shkaktuar dëm të dëmtuarit – paditësit në lartësi prej 149.64 euro, më gjerësisht sikurse në këtë aktgjykim.

Nga leximi i faturës me numër DPZ11HP06248, të datës 13.05.2011, gjykata ka konstatuar se dëmi të cilin i padituri i'a ka shkaktuar këtu paditësit, është në shumën prej 149,64 euro, më gjerësisht sikurse në këtë faturë.

### *Baza ligjore*

Me nenin 154 al.1 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD), është paraparë se “*kush i shkakton tjetrit dëmin, ka për detyrë ta kompensoj, në qoftë se nuk provon se dëmi ka lindur pa fajin e tij*”. Sipas nenit 14 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), është paraparë se “*në procedurën kontestimore gjykata më pikëpamje të ekzistimit të veprës penale dhe të përgjegjësisë penale të kryerësit, është e lidhur me aktgjykimin e formës së prerë të gjykatës penale, me të cilin i pandehuri është shpallur fajtor*”, andaj në rastin konkret gjykata vlerëson se kemi të bëjmë me detyrimin e të paditurit i cili rrjedh në bazë të kryerjes së veprës penale, i cili është shpallur fajtor me aktgjykim të formës së prerë.

*Vlerësimi përfundimtarë i gjykatës*

Gjykata pas vlerësimit të të gjitha provave të lartë përmendura dhe thënieve të palës paditëse ka ardhur në përfundim se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar dhe se e njëjta duhet të aprovohet në tërësi sikurse në dispozitiv të aktgjykimit. Kjo ngase në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar, është provuar fakti se me datën 04.02.2011, në shtëpinë e tij, i padituri M. D. në mënyrë të kundërligjshme dhe me fajin e tij, e shfrytëzonte energjinë elektrike për 6 muaj, nga ku edhe i ka shkaktuar dëm material paditësit në shumë prej 149.64 euro. Këtë gjendje faktike gjykata e ka vërtetuar duke u bazuar në provat e lartëcekura të administruara në këtë procedurë, e të cilave edhe ua fali besimin e plotë.

Gjykata ka vlerësuar edhe theksimet e tjera të palëve ndërgjyqëse, dhe ka ardhur në përfundim se të njëjtat janë me ndikim në nxjerrjen e këtij aktgjykimi.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale është marrë konform nenit 452.1 të LPK-së, dhe atë për për taksën gjyqësore në shumë prej 15 euro.

Nga të lartcekurat u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, e konform nenit 143 lidhur me nenin 485 të LPK-së.

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN**  
**C.nr.1168/13, datë. 26.12.2014**

Procesmbajtësja,  
Drita Qerreti

**Gjyqtari,**  
**Valon Totaj**

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh pas marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet të kësaj gjykate